



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:292487

Datë: 07.07.2022

Numri i dokumentit: 03272644

P.nr.352/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Dardan Hoxha, si dhe me sekretaren juridike Shemsije Shehu, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. C. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale *Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së*, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1537/2019 të datës 16.12.2019, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar, me datë 23.06.2022, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Anton Hasanaj dhe të akuzuarit R. C., më datë 24.06.2022, publikisht shpalli, ndërsa me datë 07 korrik 2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

R. C., i lindur me datë ... në Rahovec, nga i ati S. dhe e ëma H., e gjinisë T., me vendbanim në Rahovec, rruga "Xh. H.-T.", p.nr., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Më datë 22.11.2019 rreth orës 07:00 në Gjakovë, saktësisht në spitalin regional "Isa Grezda", i pandehuri ne gjendje të dehur e sulmon personin zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare dhe atë të dëmtuarit R. M., zyrtar policor, në atë mënyrë që pasi i dëmtuari kishte asistuar tek shtëpia e të pandehurit i cili kishte filluar të dëmtoj pasurinë e familjarëve të tij, i njëjti e kishte shoqëruar të pandehurin për trajtim mjekësor fillimisht në QKMF në Rahovec, e më pas në Spitalin e Gjakovës ku edhe kishte pranuar trajtimin mjekësor, ashtu që derisa i pandehuri R. ishte duke hipur në veturën e policisë, revoltohet dhe e sulmon fizikisht këtu të dëmtuarin duke e goditur me kokë në fytyrë, ku si pasojë e kësaj goditje, i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore, lëndime këto të konstatuara në ekspertizën mjekoligjore të Dr. M. G., me numër të referencës Gj-826/19, dt.11.12.2019.

-Me këto veprime ka kryer veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të neneve 4, 7, 8, 9, 17, 21, 38, 39 par. 1 pika 1.1, 40 par. 1 pika 1.2, 42 par.1, 69, 70, nenit 402 par.4 lidhur me par.2 të KPRK-së, dhe nenit 248, 365 si dhe 370 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N M E D Ë N I M M E B U R G I M

Duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e pesëdhjetë (150) ditë, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar në masën e paraburgimit nga data 22.11.2019 e deri më datë 06.12.2019 do t'i llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim.

I dëmtuari R. M., i lindur më datë ... në fshatin Polluzhë, komuna Rahovec, ku dhe jeton, me numër personal ..., lidhur me realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko - civil.

I akuzuari R. C. obligohet që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzet euro (20€), në emër të ekspertizës mjeko-ligjore të punuar nga Dr. M. G., shumë prej njëzet (20) Euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej tridhjetë (30) €, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën, PP/II.nr1537/2019 të datës 16.12.2019, kundër të akuzuarit R. C. nga Rahoveci, për shkak të veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështrim të aktakuzës, ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore.

Sa i përket kompetencës territoriale, gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPPRK-së, kompetencë territoriale për të gjykuar një çështje juridiko-penale ka gjykata në territorin e së cilës është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale, apo gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret, vepra penale është kryer në Rahovec, andaj Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec, ka kompetencën territoriale në gjykimin e kësaj çështje.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konsideron se me qenë se për veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së parashihet

dënim me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vite dhe meqenëse e njëjta veprë nuk është paraparë me nenin 22 të KPPRK-së, atëherë gjykata konstaton se departamenti i përgjithshëm ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

Gjykata, duke vepruar sipas aktakuzës, PP/II.nr.1537/2019 të datës 16.12.2019, më datë 23 qershor 2022 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar gjyqësor, ku të pranishëm kanë qenë Prokurori i Shtetit, Anton Hasanaj dhe i akuzuari R. C..

Prokurori i shtetit, pas leximit të aktakuzës bënë përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës, ku në përshkrimin faktik në rreshtin e parafundit, pas fjalisë “i dëmtuari pëson lëndime në hundë” duhet të jetë “i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore”, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pa ndryshuar.

I akuzuari R. C., pas leximit të aktakuzës dhe të përmirësimit të përshkrimit faktik nga ana e prokurorit të shtetit, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale që akuzohet, ndjehet i penduar për rastin që ka ndodhur, duke shtuar se tani është duke punuar dhe nuk po përdorë pije alkoolike, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla penale. Andaj ka kërkuar nga gjykata që ta aprovoj pranimin e fajësisë dhe me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim t’i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Prokurori i Shtetit, Anton Hasanaj lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit në seancën e shqyrtimit të fillestar gjyqësor ka deklaruar se nuk e kundërshtojnë pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari R. C. pasi që pranimi i fajësisë gjen mbështetje të plotë në provat të cilat mbështesin aktakuzën. Pranimi i fajësisë nga ana e këtu të akuzuarit është bërë në mënyrë vullnetare, duke i ditur më parë pasojat dhe benefitet e pranimin të fajësisë ashtu që gjykatës i ka propozuar që ta bëjë pranimin e fajësisë, si shprehje të lirë të vullnetit të të akuzuarit, dhe ndaj të njëjtit të shqiptojë një dënim konform ligjit dhe atë duke marrë për bazë si rrethana lehtësuese: Pranimin e fajësisë, keqardhja e shfaqur nga ana e të akuzuarit, ndërsa si rrethanë rënduese ia le në diskrecion gjykatës, po ashtu të obligohet në pagimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Pasi gjyqtari i vetëm gjykues u bind se i akuzuari e ka kuptuar natyrën, benefitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, si dhe pasi që konstatoi se pranimi është në përputhje me nenin 248 të KPPRK-së, me aktvendim e aprovoi pranimin e fajësisë së të akuzuarit, për veprën penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së.

Bazuar në aktin e pranimin të fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave në këtë çështje penale.

Gjykata, gjendjen faktike në raport me veprën penale, të përshkruar në aktin akuzues dhe në dispozitivin e këtij aktgjykimi, e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari, ku për shkak të pranimin të fajësisë, gjykata fare nuk i ka administruar provat e çështjes.

Sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 257 të KPPRK, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme, gjithashtu në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar

natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale për të cilën akuzohet. Pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e tij, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat materiale të cilat janë parashtruar me aktin akuzues, e për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale dhe të njëjtat nuk i ka kundërshtuar, por ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së, në pajtim me faktet e provat që përmban akti akuzues, ku në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par. 4 lidhur me par.2 të KPRK-së, ku për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69, 70 dhe 71 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë rënduese gjykata gjeti shkallën e lartë të dashjes në kryerjen e veprës penale, ku i akuzuari me rastin intervenimit nga zyrtarët policor, konkretisht nga i dëmtuari në cilësinë e zyrtarit policor, e sulmon fizikisht të dëmtuarin duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore. Tutje, gjykata si rrethanë rënduese gjeti se vepra penale është kryere ndaj personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare. Po ashtu si rrethanë tjetër rënduese gjykata gjeti se i akuzuari edhe më parë ka qenë i dënuar me vendim të formës së prerë si dhe ndaj tij zhvillohen procedura tjera penale, këtë fakt e ka pohuar edhe vet i akuzuari. Ndërsa si rrethana lehtësuese vlerësoi faktin e pranimit të fajësisë në këtë fazë të procedurës nga i akuzuari për veprën penale për të cilën akuzohet, pendimi i thellë për kryerjen e veprës penale, ka theksuar se është penduar për atë që ka bërë, ku këtë pendim e dëshmon edhe me vet faktin duke i kërkuar falje palës së dëmtuar.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara si më lartë, të njëjtit i shqiptoj dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e pesëdhjetë (150) ditësh i cili dënim do të ekzekutohet në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Gjykata përkitazi me dënimin me burgim morri për bazë se i akuzuari është recidivis i veprave penale, i dënuar me vendim të formës së prerë si dhe ndaj tij zhvillohen procedura penale për vepra tjera penale. Gjykata me këtë dënim konsideron se i akuzuari e ka kuptuar rëndësinë e veprimeve të dëmshme dhe se në këtë dënim gjykata mori për bazë edhe rrethanat personale të të akuzuarit, pranimin e fajësisë si dhe sjelljen e tij para gjykatës. Megjithatë, gjykata i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëqind e pesëdhjetë (150) ditë në mënyrë që i akuzuari ta kupton rëndësinë e dënimit dhe se gjykata të bindet se i akuzuari nuk do të përsëritë veprimet e tij. Gjykata vlerëson se kryesi i veprës penale, në rastin konkret R. C., do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara, përkatësisht mos të kryej vepër penale, e çka është edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-se. Gjykata ka bindjen se një dënim i tillë është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit.

Nga të gjitha këto, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në

proporcion me peshën e veprës penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla kundërligjore, si dhe një dënim i tillë do t'i parandalojë edhe personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Në rastin konkret siç është theksuar edhe më sipër, po që se gjykata nuk do të gjente asnjë rrethanë lehtësuese, marrë për bazë rrethanat rënduese të rastit, të akuzuarit do t'i shqiptonte dënim edhe më të ashpër. Megjithatë kjo gjykatë konsideron që ky dënim është i mjaftueshëm dhe i domosdoshëm që i akuzuari ta kuptoj rëndësinë e veprës penale që e ka kryer e po ashtu edhe rëndësinë që ka për pasojë sanksioni penal.

Vendimi për llogaritjen e masës së paraburgimit në dënimin e shqiptuar, është marrë në bazë të nenit 79 par.1 të KPRK-së, ku është paraparë se *“Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim ...”*. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, gjykata ka bërë llogaritjen e kohës së kaluar nën masën e paraburgimit në dënimin e shqiptuar, ashtu siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës, në kuptim të nenit 453 paragrafi 1 i KPPRK-së, ngarkoi të akuzuarin lidhur me shpenzimet e procedurës dhe të njëjtin e obligoi të paguaj shumën prej 20€ (njëzetë euro), në emër të ekspertizës mjeko-ligjore të punuar nga Dr. M. G.. Në këtë drejtim, gjykata e obligoi të akuzuarin që konform nenit 450 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 të KPPRK-së, të paguaj shumën prej 20€ (njëzetë euro), në emër të paushallit gjyqësor. Po ashtu, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të akuzuarin të paguaj shumën prej 30€ (tridhjetë euro), në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata vendosi në kuptim të nenit 462 par.2 të KPPRK-së, ku të dëmtuarin R. M., për realizmin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontestin e rregullt juridiko civil.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.352/19, datë 07 korrik 2022

Sekretarja juridike,
Shemsije Shehu

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Dardan Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.